



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1913/ 12 prot.

Datë 29/08/2024

V E N D I M
Nr. 1137/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 29/08/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024 për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.

Ankimues: Operatori ekonomik “AEK MUNELLA” SHPK me NIPT: J98926001P dhe me adresë: *Lagjja "Gjakez" 2 ndërtesë me nr. pasurie 40, zona kadastrale 1717, Fan, Mirditë, Lezhë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mirditë
Adresa: Sheshi “Abat Doci”, Rrëshen.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 13.08.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024, ku vendosi:

[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “AEK MUNELLA” ShPK për procedurën e prokurimit “AEK MUNELLA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “AEK MUNELLA” ShPK për procedurën e prokurimit “AEK MUNELLA” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “AEK MUNELLA” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3180/1 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1913/9 prot., datë 26.08.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024, njofton se: “Bazuar në ligjin 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin 36/2024, në VKM nr 285 dt.19.05.2021 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe në ankesën në sistemin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr aplikimi A/2024/4321, e padepozituar në mënyrë shkresore në Bashkinë Mirditë, referojmë si më poshtë:

Pas marrjes së ankesës në sistem me nr aplikimi A/2024/4321, Bashkia Mirditë ngre urdhrin nr 339 datë 19.07.2024 "Për Pezullim Procedure dhe caktim personi për shqyrtimin e ankesës".

...

Pas administrimit të Vendimit të KPP-së nr. 1036/2024 me nr 3186 Prot, datë 19.08.2024, të Bashkisë Mirditë, personi përgjegës gjatë ndërhyrjes në sistem nuk ka arritur të modifikojë dokumentet e tenderit sepse gabimisht procedura ishte nxjerrë nga pezullimi pa bërë modifikimet përkatëse.

Gjatë ndërhyrjes nga administratori për të bërë pezullimin prapë të procedurës, nuk u bë e mundur sepse një veprim i tillë bëhet para datës së hapjes së ofertave që ishte 30.07.2027, datë që ka kaluar.

Të ndodhur në këto kushte kërkojmë nga ana Juaj LEJIMIN e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Mirditë, të bëjë Anullimin e Procedurës në sistem me nr REF-12492-07-09-2024, dhe rihedhjen e saj duke zbatuar Vendimin e KPP nr 1036/2024 për hartimin e DT.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin shpresojmë në kthimin e përgjigjes Suaj, në mënyrë që të realizohet sa më shpejt procedura dhe investimi njëkohësisht.”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3180/1 prot., datë 23.08.2024, protokolluar me tonën nr. 1913/9 prot., datë 26.08.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë, lidhur me zbatimin e Vendimit Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024, njofton se: “Bazuar në ligjin 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin 36/2024, në VKM nr 285 dt.19.05.2021 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe në ankesën në sistemin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr aplikimi A/2024/4321, e padepozituar në mënyrë shkresore në Bashkinë Mirditë, referojmë si më poshtë:

Pas marrjes së ankesës në sistem me nr aplikimi A/2024/4321, Bashkia Mirditë ngre urdhrin nr 339 datë 19.07.2024 "Për Pezullim Procedure dhe caktim personi për shqyrtimin e ankesës”.

...

Pas administrimit të Vendimit të KPP-së nr. 1036/2024 me nr 3186 Prot, datë 19.08.2024, të Bashkisë Mirditë, personi përgjegës gjatë ndërhyrjes në sistem nuk ka arritur të modifikojë dokumentet e tenderit sepse gabimisht procedura ishte nxjerrë nga pezullimi pa bërë modifikimet përkatëse.

Gjatë ndërhyrjes nga administratori për të bërë pezullimin prapë të procedurës, nuk u bë e mundur sepse një veprim i tillë bëhet para datës së hapjes së ofertave që ishte 30.07.2027, datë që ka kaluar.

Të ndodhur në këto kushte kërkojmë nga ana Juaj LEJIMIN e Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Mirditë, të bëjë Anullimin e Procedurës në sistem me nr REF-12492-07-09-2024, dhe rihedhjen e saj duke zbatuar Vendimin e KPP nr 1036/2024 për hartimin e DT.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin shpresojmë në kthimin e përgjigjes Suaj, në mënyrë që të realizohet sa më shpejt procedura dhe investimi njëkohësisht.”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kryer modifikimin e dokumentave të tenderit sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nuk e ka anuluar procedurën e prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF12492-07-09-2024, me objekt “Rikostruksion i rruges fsahti Jezull, ne bashkine Mirdite”, me fond limit 24,650,725 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 30.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mirditë.
2. Autoriteti kontraktor të anultojë procedurën e prokurimit, si dhe të dërgojë pranë KPP-së njoftimin e anulimit dhe dokumentat e reja të kësaj procedure prokurimi të rishpallur ku të reflektojë në këto dokumenta tenderi përcaktimet e Vendimit Nr. 1036/2024, datë 13.08.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të dërgojë këto dokumenta pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

